

Katërbëdhjetë

ÇAJUPI  
vjeç dhëndër



Komedi e  
vjershëruar me  
katër pamje



A. Z. Çajupi

KATËRMBËDHJETË VJEÇ  
DHËNDËR!

Komedi e vjershëruar me katër pamje



### NJERËZIT E KOMEDISË

Zoti VANGJEL     *plak i pasur*  
Zonja TANË       *gruaja e tij*  
GJINI             *djali i tyre*  
MARIGO           *nuse e tij*  
Zonja KOTE       *kushërira e Tanës*  
Zonja BRIRI      *një lehonë*  
Një millona  
Prifti, Nuni, Brodani, Abazi, krushq, gra, burra të tjerë,  
çupa, djem



## **PAMJE E PARË: BURRË E GRUA**

*(Është natë. Mbrënda në një odë për të fletur, zoti Vangjel e zonja Tanë bënen azër për të rënur. Në fund të odës ndrit një llambë afër shtratit.)*

Tana  
Ndëgjo, burrë...

Vangjeli  
Ç'ke, moj grua?

T. *(Rënkon)*  
Jam sëmurë.

V.  
Që kur! Ç'thua?

T.

Ç'them? Ja them që jam sëmurë,  
koka më digjet si furrë;  
s'e keshë pësuar kurrë.

V.

Po tani vallë ç'pësove?  
Më duket se u ftove;  
gjithë natën u zbulove  
dhe s'më lë fare të flërë!

T.

Gjithë ditën ç'keshe bërë?  
Ti për bar e për dru s'vete  
dhe qaej<sup>1</sup> se nukë flete?  
Tërë ditën ngas qetë  
dhe drek' e darkë bëj vetë,  
gjithë puna përmi mua!

V.

Përse të kam marrë grua?  
Gratë për punë po janë.

T. (*Qesëndis*)

Edhe burratë të hanë  
dhe të rrinë nat' e ditë!

V. (*Me inat*)

Mos më bën të të godit,  
se zakonë s'e harrova,

---

<sup>1</sup> qahesh

sonte shumë të durova.  
Nga hunda s'më heq dot kurrë,  
se nuk' jam si çdo burrë!  
Jam shqipëtar i vërtetë,  
do të bëj si dua vetë!  
Ç'ke që s'pushon duke qarë?  
Nga u<sup>2</sup> ç'të ligë ke parë?  
S'të kam lënë si të tjerë,  
Vetëm, të shkret' e të mjerë.  
Nukë ika kurrë nga fshati.  
Eja, s'të shkoi inati?  
Ngreu të biem të flëmë  
dhe këto fjalë t'i lëmë.

T.

Bjer e fli, mua s'më flihet.

V.

Nesër, porsa që të gdhihet,  
do t'dërgoj djalën me vrapë  
të bjerë jatronë<sup>3</sup> prapë.

T.

Cinë jatro?

V.

Adhamutnë.<sup>4</sup>

---

<sup>2</sup> unë

<sup>3</sup> mjekun

<sup>4</sup> Çajupi e ka fjalën për Adhamidh Frashërin, një ndër figurat kryesore të lëvizjes së shqiptarëve të Egjiptit.

T.

S'e shoh dot me sy çifutnë,  
as për mace s'i vë besë!

V.

Le, moj grua, ta thërresë,  
kokën mund të ta shërojë.

T.

Nuk' e dua të më shojë!<sup>5</sup>  
Të bukur jatro që gjete!  
Më p'hair të ruaj qetë.

V

Mos kuvëndo kështu, moj grua.

T. (*Me inat*)

Nuk' e dua, nuk' e dua!  
Pse s'shëron gruan e tij?  
Se nga ajo ha e pi...  
Ndaj e mori me një sy,  
i dalçinë që të dy.

V

Ç'jatro të të bie unë?  
Mitrua s'është këtunë,  
dhe Naum kokëshiniku  
këtejë natën iku. . .  
Në vende të tjerë vanë,  
këtu vetëmë na lanë,

---

<sup>5</sup> shohë

ikn' e muarë Misirë,  
u hante koka për brirë.<sup>6</sup>

T.

Prapa diellit të venë,  
se çnderuan mëmëdhenë,  
s'jam sëmurë për jatrua,  
se s'më ka gjë koka mua,  
Po të më ndëgjosh një fjalë.

V.

Folë, ç'do të thuash vallë!  
Do t'më lësh dhe sot pa gjumë?

T.

Kemi ara, vreshta shumë. . .

V.

Të gjitha ç'duhën i kemi,  
si do zoti vetë jemi;  
si ne s'ka shumë të tjerë.

T.

Sa qe e ndyera<sup>7</sup> vjehrrë,  
pas takatit<sup>8</sup> pleqërisë,  
bënte punët e shtëpisë,  
dhe kur ktheneshë nga ara,  
gjejë darkënë përpara;

---

<sup>6</sup> Dëshën të turpëroheshin

<sup>7</sup> e ndjera

<sup>8</sup> pas fuqisë (aq sa mundej)

Po tani, ç'të bëj më parë,  
në vështë<sup>9</sup> të jem a nd'arë?  
Të të bëj dhe drek' e darkë?  
Tani s'mund, se jam më plakë.

V.

Plakë? S'je plakë, moj grua,  
po je ashtu si të dua.

T. (*Me të lutur*)

Të të vijë keq për mua:  
punëtë janë të rënda,  
S'punoj dot jashtë dhe brënda.

V.

Puno sa të duash vetë,  
arat jepi me të tretë.<sup>10</sup>

T.

Kjo punë s'bënetë kurrë,  
po djali na u bë burrë.  
Ndaj të lutem ta martojmë,  
erdhi dita të gëzojmë.  
Ne pa nuse pse të rrimë?  
Kur të kem nusenë ndihmë,  
punëtë bënenë vetë.  
Nukë rrojmë me jetë!<sup>11</sup>  
Pse s'më flet?

---

<sup>9</sup> vreshtë

<sup>10</sup> me qera

<sup>11</sup> Nuk do rrojmë përgjithmonë

V

Ç'të them, moj grua?  
Çuditëm me ç'fjalë thua!  
Katërmëdhjetë vjeç djalë  
do ta martosh?

T.

Sa jam gjallë,  
dua të gëzoj si mëmë!

V.

Eja të biem të flëmë.

T.

T'i ç'më thua, u ç'të them!  
Sikur kemi shumë djem!  
Me Gjinë mbeti kjo derë.

V.

Qasu të të bëj të tjerë,  
të pjellç, pa mbushurë moti...

T. *(Duke qarë)*

Me fjalë je shumë i zoti.

V.

Ç'ke që qa<sup>12</sup> prapë taninë?

---

<sup>12</sup> qan

T. (*Me lot*)

Ku të mos qaj un' e mjera?  
U të flas me perëndinë,<sup>13</sup>  
ti më flet fjalë të tjera!

V.

Eja moj grua nër mënde.

T.

Çuditem me kokën tënde.

V.

Sado<sup>14</sup> qave, ngreu bjerë.

T.

S'je baba si të tjerë!  
Thuajmë, për perëndinë,  
pse s'do ta martojmë Gjinë?

V.

Ësht' i vogëlë, moj Tanë!

T.

Ç'thua! Pa shikoi shtanë.  
Bota nukë shonë vjetë.  
Shihe sa mori përperjetë:  
duketë njëzet vjeç djalë,  
kur hipën e breth me kalë.  
Me mua kur u martove,

---

<sup>13</sup> me zemër të hapur ,me singeritet

<sup>14</sup> mjaft

sa vjeç jeshe, mos harrove?  
Tani për djalënë tonë  
do të ndërrojmë zakonë?

V.

Mos kërko ç'bënim njëherë,  
Po shuko<sup>15</sup> ç'bëjnë të tjerë:  
Shuko bejnë rrënjëdalë,  
nukë ka dhe ai djalë?  
Kur i thashë ta martojë,  
«Le të bëjë si të dojë,  
s'më ha malli për tim birë,  
u për vete të rroj mirë"  
më tha dhe më ktheu kratë.<sup>16</sup>

T.

I muarë mëntë gratë!  
Të bukur njeri që gjete!  
Ai të kish mënt për vete,  
nukë shkretonte shtëpinë,  
s'kish marrë porropotinë!<sup>17</sup>  
Mëndjeprishur, zemërligu,  
la të shoqenë dhe iku!  
E zeza grua se ç'hoqi!  
Njëzet vjet e la i shoqi  
dhe në pleqëri q'e poqi,  
(Të mos arrij' të kish ardhë!).  
nukë pa ditë të bardhë:

---

<sup>15</sup> shiko

<sup>16</sup> krahët

<sup>17</sup> arratinë

nat' e ditë duke qarë  
 nga turpetë që kish parë.  
 E mba mënt ç'grua ka qënë?  
 S'kishte shoqe në vënd tënë:  
 e nderçme, zëmërmirë,  
 punoi e rriti të birë.  
 Ka qenë grua për mbretinë,  
 burri s'ja diti kimenë.<sup>18</sup>  
 Dhe tani në pleqëri,  
 dashuri më dashuri!  
 E gjetë nga perëndia,  
 se prishi shtëpin' e tia!  
 Gruaja vdiq nga qeder!<sup>19</sup>  
 Këtë kërkonte dhe derri:  
 tani mban disa të tjera,  
 i vaftë shpirti në ferra!

#### V.

Pse kuvëndon kështu, moj Tanë?  
 Njerzt' e mëdhenj kështu e kanë:  
 Njerzt' e tyre i mundojnë,  
 duan ata q'i lëvdojnë.

#### T

Në bëjnë kështu të mëdhejtë,  
 djalli t'i marrë për jetë!  
 Beu djalën ta martojë!  
 Me sy nukë do ta shojë,<sup>20</sup>

<sup>18</sup> s'e diti fatin

<sup>19</sup> nga merakun

<sup>20</sup> shohë

se në turpe do të rrojë,  
si ka rrojturë ngaherë!  
Dhe guxon e mson të tjerë!  
Ka lojturë nga fiqiri.<sup>21</sup>  
Një ditë më thosh i biri:  
"Baban' e mirë nderoe,  
dhe baban' e lik duroe".  
Do të bënet djal' i mbarë,  
se me mëmënë ka gjarë,<sup>22</sup>  
pa në gjaftë me babanë...

V

Minji gdhietë, moj Tanë!  
Tani le bejnë mënjanë  
dhe hajde të flemë pranë,  
eja se më mori gjumi. (*Shtrihet*)

T.

Dhe mua më marrtë lumi!

V.

Pa dhe nesër kuvëndojmë

T.

Djalënë do ta martojmë?

V.

Pa të shomë. . .

---

<sup>21</sup> mendja

<sup>22</sup> ngjarë

T.  
Ço të shoç?<sup>23</sup>  
Nukë do të më ndëgjoç!  
Ndëgjo dhe mua një herë.

V.  
Të ndëgjoj, po hajde bjerë.

T.  
Të vi, po të më apç<sup>24</sup> fjalën,  
që do të martojmë djalën.

V.  
Puna, s'bënet me një natë,  
do menduar gjër' e gjatë.

T.  
Ç'do menduar, pa më thua?

V.  
Ç'vajzë do t'i apëm<sup>25</sup> grua?

T.  
Mos e ki këtë qeder:  
djalën tënë kush s'e merr?  
Kush nuk' e do Gjinon tim,  
q'është nga trimat më trim?

---

<sup>23</sup> Çfarë të shohësh?

<sup>24</sup> japësh

<sup>25</sup> japim

V.

Trimërinë s'ja nxë dheu!

T.

Nukë është si djalë beu. ..  
po është' i mir' e i mbarë,  
kush ta rrëmbejë më parë.  
S'është ndonjë djal' i mbetur  
unë nusen ia kam gjetur.

V.

Ja ke gjetur! Po ç'e thonë?

T.

Çupën e gjitonit<sup>26</sup> tonë.

V.

Cinë çupë, Marigonë?  
Çupën e zotitë Kore?

T.

E bukur e punëtore.  
Mos e pyet ç'grua është!  
Si për ara dhe për vështë,  
pun' e saj s'gjëndet në jetë,  
Punon vetëmë sa dhjetë!  
Nukë them mirë? Ti ç'thua?

V.

Në do të më ndëgjosh mua,

---

<sup>26</sup> fqinjit

Gjini Katonë të marrë,  
të bëhem krushk me korçarë. . .  
Ara, vreshta shumë kanë.

T.

Po kanë veqil<sup>27</sup> xhaxhanë,  
nuk u jep bukë të hanë!  
Janë për të qarë hallë,  
se të tjer' u hanë mallë:  
tek ata që s'kanë mënt,  
erëgjëndi nukë zë vënt,  
xhaxhai pse s'i marton?  
Se vetë thon' i punon!

V.

Thonë bota për xhaxhanë?  
Kjo punë s'bënet, moj Tanë,  
as në turq, as në kaurë.

T.

Tym pa zjarr nukë ka kurrë.  
Ndaj s'i do njeri në fshat,  
i shukojnë si lugat...  
Kanë edhe Jorgjin kunat,  
i nxjerr vetë në mëzat,<sup>28</sup>  
i taks andej e këtejë,  
cinë munt që të gënjejë:  
gënjeu nja gjasht' a shtatë!  
Të mjerët! Humbnë paratë,

---

<sup>27</sup> zëvendës, dorëzënës

<sup>28</sup> me kuptimin: në shitje, në shesh, në pazar

se harruanë xhaxhanë,  
q'e kish vluar<sup>29</sup> me çobanë.

V.

Mos dëgjo bota se ç'thonë.

T.

Ti pse s'e do Marigonë?  
Ajo nuse bën për mua.

V.

Po është e madhe, moj grua.  
Njëzet vjeçe!...

T.

Kaq e dua,  
nukë marr nuse për sisë,  
po për punët e shtëpisë:  
të dijë të ngasë qetë,  
se nukë mund t'i ngas vetë,  
të na bëjë dru nga mali.

V.

Mirë ti, po ç'thotë djali?  
Gjini me të do të rrojë.

T.

Doemos që do të dojë!  
Pse kuvëndon kshtu, mor burrë?  
Pyeten fëmia kurrë?

---

<sup>29</sup> fejuar

Ta martojm' ashtu më rruash.

V.

Moj grua, bën si të duash  
dhe më qafë t'i kesh vetë!

T.

Em këtu, em n'atë jetë!...<sup>30</sup>  
Nesër do t'vete të bluaj,  
të shëtunë të gatuaj,  
të diel të bëjmë dasmë,  
gjithë miqtë t'i gërshasmë.<sup>31</sup> (*Qan*)

V.

Tani pse qa?

T.

Qa nga gazi:  
më shpëtove nga marazi.<sup>32</sup>  
Tani do të bënem vjerrë!

V.

Shuaj dritën dhe shko bjerë.

*(Të dy bien të flënë në shtrat. Perdja mbyllet.)*

---

<sup>30</sup> Dhe këtu, dhe në botën tjetër

<sup>31</sup> t'i ftojmë

<sup>32</sup> hidhërimi, brenga

## **PAMJE E DYTË: NË MULLI**

*(Brënda në një mulli dy gra presën të bluajnë: zonja Tanë dhe zonja Kote. Guri i mullirit po kthehet. Duken thasët pranë koshit. Zonja Kote kërkon të bluajë më parë, po Tana s'e le).*

Tana  
Ç'bën ashtu, moj Kote?

Kote  
S'është puna jote.

T.  
Moj, mos je e marrë?  
Kam ardhë më parë.

K.  
S'mund të rri këtunë,  
kam të tjera punë,  
po hiq nga unë!

T.  
Ç'thotë kjo murtajë!<sup>33</sup>

K.  
Ujku të të hajë!

T.  
Tutje, moj mandatë!<sup>34</sup>  
Kam ardhë me natë.

K.  
Thuaj si të duash,  
se u' do te bluaj.

T.  
Nukë do të bluash,  
se u' këtu ç'ruaj?

K.  
Ruaj millonanë,<sup>35</sup>  
se kur të ka pranë...

T.  
Ftu! Moj gojëndyrë,  
moj turi lëtyrë!  
Ç'e kam millonanë?  
Kam burrënë pranë...

---

<sup>33</sup> sëmundje e rëndë ngjitëse

<sup>34</sup> lajm i zi, i keq

<sup>35</sup> millona - mullixhi

Ti ku e ke nderë,  
që përflet të tjerë?  
Po gjithë të dinë.  
Harrove bekshinë?<sup>36</sup>  
Sa herë të zunë?

K.  
Me bekshinë unë!  
S'turpëronej pakë,  
se je grua plakë!

T.  
Plakë? Pa hap sytë,  
kush është m'e ndytë?  
Jeshe ti për burrë?  
Ndaj iku i mjerë  
dhe s'të vjen më kurrë,  
se i prishe nderë!

K.  
Moj kurvë, moj shtrigë!

T.  
Moj grua e ligë!

K.  
Moj sterrë, moj natë!

T.  
Moj gojëlopatë!

---

<sup>36</sup> rojtar i vreshtave dhe arave

K.  
Moj byth' e kuisë!

T.  
Tmerr i njerësisë!

K.  
Na! Porrato paç,  
kur kërkon të shaç!

T.  
Tutje, moj zagare!

K.  
Tutje, moj murdare!

T.  
Ikë, moj bishtdredhur!

K.  
O moj brashnj'<sup>37</sup> e hedhur!

T.  
O moj vjedharake!

K.  
O moj shulanake!

Millonai  
Ç'kini që thërrini,

---

<sup>37</sup> kundër, këpucë

pak turp nukë kini?  
Jini kushërira.  
Silli si të pira!  
Pse thërret, moj Kote?

K.  
S'është puna jote.

M.  
Zonja Tanë, ç'patët?

T.  
S'kam ardhë me natë?

K.  
Po sepse ke ardhë?

T.  
Të bluash me radhë!

M.  
Thotë mirë.

K. (*Shtyn millonanë*)  
Ç'thua?

M.  
Pse shtyn, ç'ke me mua?

T. (*Te millonai*)  
Ç'e shukon, ç'i thuaj?

Kam ardhë të bluaj  
se martoj evlanë!<sup>38</sup>

M.  
Ç'faj të kam, moj Tanë?

T.  
Le thesnë, moj natë!

M.  
Kthenet guri thatë!  
E gjeç më perëndinë!  
Më prishtë mullinë!...  
*(Bën të dalë.)*

T.  
Ku vete?

M.  
Ç'më thuaj?

T.  
Kur të vi të bluaj?

K.  
Kurrë, kurrë, kurrë! *(Dhe ikën.)*

M.  
Kur të skalis gurë.  
Ikë në ke punë,

---

<sup>38</sup> fëmijën

pa ta bluaj unë.

T.

Sa të ndreqetë mulliri,  
do t'vete te zonja Briri;  
ka dy dit' që polli msova  
dhe akoma s'e urova.  
Të vete sot ta uroj  
edhe më dasmë ta ftoj.  
Shuko, mos më lesh pa miell,  
të viç në dasmë të diel.

## **PAMJE E TRETË: URIME**

*(Ndë një odë për të fletur zonja Briri gatuan gjellë për të ngrënë, kur hyn zonja Tanë për të uruar. Kur e sheh, zonja Briri, që është lehonë dhe ka frikë se mos e marrë sysh, shtrihet në stromë<sup>39</sup> pranë foshnjës që ka pjellë e që e ka vënë në djep.)*

Tana  
Mirë që shpëtove!  
Po ç'dit' u lërove?<sup>40</sup>

Zonja Briri  
Duke gdhir' e martë.

T.  
Qoftë këmbë mbarë.  
Dy dit' që ke pjellë

---

<sup>39</sup> dyshek

<sup>40</sup> u çlirove (linde)

dhe ngrihesh bën gjellë!  
Kshtu jeshë dhe unë;  
polla të shtunë,  
të diel u ngrita,  
dola e vadita;  
dhe djalën e parë  
e kam bërë nd'arë!  
Në piqi<sup>41</sup> e vura,  
në shtëpi e shpura,  
dhe në sis' e kisha,  
kur erdhë nga kisha.  
Burri u mahnit,  
vjehrra u çudit.  
U ngreç, u ndërrova,  
zura e gatova,  
drek' e darkë shtrova.  
Sot të tjera thonë:  
kush është lehonë,  
jashtë të mos dalë.  
Këto janë fjalë!...  
Hëngre ndonjë çikë?  
Pive nonjë pikë?  
U mundove shumë?  
Pse s'flet, mos ke gjumë?  
Do të rri dhe pakë,  
se s'kam bërë darkë.  
S'iki pa shukuar  
foshnjën e bekuar...  
Ftu, ftu, ftu! Të rroftë,  
zoti ta dhuroftë,

---

<sup>41</sup> prehër

këmbëmbarë qoftë!  
Posi lul' e mait!  
Nukë i ngjan babait,  
gjyshit i ka ngjarë.  
Ti s'e keshe parë:  
qe një burr' i bukur,  
nga shokët m'i dukur...  
Ndjesë pastë, mua  
doj të më mirr grua;  
mëma me babanë  
një tjetër i dhanë.

*(Te foshnja)*

Ftu, ftu, ftu! Mos qa!

*(Te mëma)*

Pa shih vallë ç'ka?  
Pa nxirre nga djepi,  
në do sisë jepi.

*(Te foshnja)*

Ç'ke që qan, moj zemër?

*(Te mëma)*

Mashkull është' a fëmër?

B.

Vajzë.

T.

Të të rrojë,

zoti ta madhojë.  
Ndaj të shoh menduar  
dhe të hidhëruar!

B.

Doje të qe djalë.

T.

Ç'janë këto fjalë?  
Ç'e keqe të zuri?  
Të të rrojë burri,  
me shëndet të vijë,  
ju jini fëmijë...  
Pse qesh? Tek të them:<sup>42</sup>  
do të bësh dhe djem.

*(Pshyn<sup>43</sup> foshnjën.)*

Ftu, ftu! Kush ta shojë,  
ta mpshyjë në gojë.  
Është lodërtare,  
si motëmoçare!  
Shumë njerz, moj bijë,  
kanë për fëmijë  
sy të lik, mos qoftë!  
Zoti i verboftë!  
Unë, paça zonë,  
mos ndëgjo se ç'thonë,  
se kam sy të mbarë.  
Një ditë të marë

---

<sup>42</sup> ja ku të them...

<sup>43</sup> pështyn

poqa Sanën nd'arë  
 punonte sa katrë!  
 S'i thashë gjë tjetër,  
 puna mbar' i thashë  
 dhe ika e lashë.  
 Sana qe me barrë,  
 po s'e keshë parë!  
 Tër' ditën punoi,  
 natënë dështoi!  
 Mua ma ngarkoi!  
 Dil e thosh, murtaja,  
 te shoqet e saja  
 dhe në gjithë botë:  
 "Tana, zemërliga,  
 më vu synë, shtriga  
 prandaj dështova!"  
 Po pas ca dit' msova,  
 o moj zonja Brirë,  
 se Sana kish shtirë,<sup>44</sup>  
 se burri qe pirë  
 dhe e rrah' mirë,  
 mbrëmane, ndajnate,  
 me një bisht lopate,  
 se s'kish bërë gjellë.  
 Pa shih, ç'ka jot pjellë?

*(Te foshnja)*

Ç'ke, moj vogëlane?  
 Ç'ke, moj bukurave?  
 Ç'më kërkon, ç'më thua?

---

<sup>44</sup> kishte dështuar

S'më di, s'më njeh mua?  
Unë jam hall' Tana,  
Korba! Ra kambana!

B.  
Mori sperinoi!<sup>45</sup>

T.  
Moj motra, ç'më thoi?

B.  
Shkoi dit' e shkretë!

T.  
S'bëj dot as dy petë.  
Kush dëgjon Vangjelë,  
kur nukë ka gjellë!  
Sot do të durojmë,  
shkojmë si të shkojmë,  
me bukë' e me gjizë.  
Tani nemni izë,<sup>46</sup>  
më mbajtit me fjalë!  
Mos u ndodhet dhallë?

B.  
Sot tunda.

T.  
Më rrofsh!

---

<sup>45</sup> esperino (mbrëmja)

<sup>46</sup> më jepni leje

Të mos kthenem bosh.  
Pa bagëti jemi,  
dhe dy dhi që kemi,  
sivjet mbenë shterpa  
si Syska dhe Bejka.

*(Ngrihet)*  
Nat' e mirë! Ika!

*(Kthehet prapë)*  
Vaj! Më rëntë pika!  
Moj korba, s'më thoi,  
kush e pagëzoi?

B.  
Zoti Koto vetë.

T.  
T'i rroj' e ta ketë!  
I lumt' ajo dorë,  
vëntë dhe kurorë.  
Ç'emër i ka vënë?

B.  
E quajti Hënë.

T.  
Moj sterra, moj nata!  
U arhtë mandata!  
Zemrën ma lënduat,  
nuk' u turpëruat!

B.  
Ç'pate?

T.  
Ç'faj më kini?  
Bëni sikur s'dini?  
Vajza që m'ka lënë  
nukë quhej Hënë?

*(Duke qarë.)*  
Njëzet vjet mbuluar!  
Më ka përvëluar!  
Kur gjegj<sup>47</sup> këtë emër,  
zhuritem<sup>48</sup> në zemër!  
E zeza ç'ndëgjova!  
Dhe arç' e urova!  
Mos e trashëgofshi!  
Si un' e pësufshi!

B.  
Më t'u thaftë gjuha!

T.  
Qënkej palo grua!  
Qënki njerz të ndytë! *(Dhe del)*

B.  
Mos të pafsha sytë!

---

<sup>47</sup> (këtu) dëgjoj

<sup>48</sup> digjem

## PAMJE E KATËRT: DIT' E DASMËS

*(Ndë odë të krushqet, sofrë plot me mish të pjekur në hell. Burra, gra, çupa, djem, këndojnë a hedhin valle. Çoku kërcet ndonjë pushkë. Burrat e shtrojnë me dolli, dhëndri rri më këmbë, dhe dy a tri trima qerasin krushqit pas urdhërit "dolibashit". Këto të gjitha bëhenë më darkë.)*

### I.

#### **Gratë vetëm:**

A të pëlqen nusia,  
more djal' o lulia?  
Është' e mir' e shoqe s'ka,  
m'e mirë nga gjithë na.  
Nusia si zogë deti,  
sikur është bijë mbreti.

### **Gra e burra bashkë:**

Ç'mirë ja bëm' krushkësë,  
q'i muarm të bijënë,  
atë më të mirënë,  
Maro gjeraqinënë.

### **Burrat vetëm, në valle:**

Moj unaza rreth me ar,  
për grua do të të marr,  
gjithë të kanë nakar.<sup>49</sup>  
nakar le të kishninë,  
sa të mos pëlçisninë.  
Moj unaza rreth flori,  
gjithë të kanë zili,  
se do të të marr ndë gji.  
Zili le të kishninë,  
sa te mos pëlçisninë.

## **II**

*(Burrat rrinë përdhe të pinë me dolli.)*

### **Nuni:**

Djalë, bjerë,  
shtjerë verë  
shtjerë, shtjerë  
në të tjerë.

---

<sup>49</sup> zili, smirë

Pini vere,  
mor të mjerë,  
se qederë  
do t'ua nxjerrë.

**Gjithë burrat:**

Kush e pi këtë dolli?  
Zoti nun me trimëri,  
i gëzofshim më shtëpi!

**Nuni te prifti:**

O prift, të kam gjetur!  
Pa pirë ke mbetur,  
të gjej me kupë me verë  
të ëmbël si sheqerë.

**Prifti**

Tek unë mir' se të vish.

**N.**

Këtë ta dish e ta pish  
për shëndet të dhëndërit,  
që rri më këmb' e dremit.

**Gjithë tok**

Shëndet të mirë të ketë,  
të trashëgonet për jetë! (*Kërcet një  
pushkë.*)

**P. (Te nuni)**

Zoti, nun, mir' se më erdhe!

Po verën pse na e derdhe?

**N.** *(Te prifti)*

Mir' se të gjeta, uratë,  
të kesh jetënë të gjatë.  
Kupën e piva me fund  
dhe më tutje, mo e tund.

**P.**

S'e pi dot, jam prift njeri.

**N**

Të di, uratë, të di. . .

**P.**

Kur e bën emërë vetë  
pikë në kupë mos mbetë!  
Ti që vure sot kurorë,  
pagëzofsh edhe me dorë.

**Gjithë tok**

Nuni që vuri kurorë,  
pagëzofhtë e me dorë!

**P.**

Urdhër, o nun, se jam plak,  
të lutem, bëmë konak.

**N.**

Konak? Gjej Vangjel' e shkretë.

**P.**

Këtë kërkojë dhe vetë!  
Vangjel, e mira të gjetë.

**V.**

Me një kupë ç'do të jetë?

**P.**

E di mirë kush martonet?  
Djali të të trashëgonet.  
Do ta pi pas urdhërit,  
Për shëndet të dhëndrit!

**Gjithë tok**

Dhëndëri të trashëgonet,  
të gëzonet e të shtonet!

**V**

S'e pive të tër' uratë!

**P.**

Përmbys e ktheva, s'e patë?

**V.**

O prift, mirë se urdhërove,  
rrofsh e qofsh që më nderove!  
Dhe dollibashi na rroftë,  
dhëndëri ju trashëgoftë!  
Gëzofsh dhe në derë tënde!

**N**

Dhe zoti të dhëntë mënde!...

**V.**

Unë verën s'e kam pirë  
që të mos kuvëndo mirë...  
Po dilmi, paskam mënt pak,  
të lutem bëmë konak.

**N.**

Ç'konak kërkon të më thuash?

**V.**

Dërgomë ku do të duash!

**N.**

Zotnë Brodanë të gjësh  
dhe si të duash të bësh!

**V.**

O zoti Brodan, të gjeta!

**B.**

Mir' se erdhe, t'u ngjatë jeta'

**V.**

Këtë kupëzë, ta dish,  
për dhëndërin plot ta pish.

**Gjithë tok**

Dhëndëri shumë të rojë,

jetë të mirë të shkojë!

**B.**

Zotrote që gjete mua,  
më shtëpi ta paça hua!  
Dhe dollibashi me nder,  
u bëftë dhe vetë vjehrr  
dhe rroftë sa shkëmb' i malit.

**N.**

Gëzofsh më dasmë të djalit!

**B.**

Ku do t'më dërgosh të pshtetem,<sup>50</sup>  
se do të pi e mos dejtem.<sup>51</sup>

**N.**

Ecë pshtetu te Abazi,  
s'ka pir' e ju tha gurmazi.

**B.**

Të gjeta, Abaz i mjerë!

**A.**

Kshtu të më gjesh kurdoherë!

**B.**

Këtë kupë do ta kthej

---

<sup>50</sup> të mbështetem (formulë tavoline)

<sup>51</sup> dehem

për shëndet të këtij bej.  
(*Rrëfen dhëndërin.*)

**Gjithë tok**

Me nuse të trashëgonet,  
nga e liga të mërgonet!

**A. (*Te nuni*)**

Dollibash, të qofsha falë,  
zoti të faltë një djalë!

**N.**

Rrofsh e qofsh!

**A.**

Kush më ka gjetur?

**N.**

S'e ndëgjove? Keshe fletur?  
Të ka gjetur Brodan Duni.

**A.**

Më ke gjetur, thotë nuni,  
të gjet' e mira përjetë,  
të rrosh sa të duash vetë.

**Gjithë**

S'mba mënt? U deje pa pirë?

**A.**

Dhe në mos kuvëndo mirë,  
un, i mjeri jam çoban:

sos jam, i ziu, në stan,  
dhe sos jini dhën e dhi,  
të di për cinë të pi.

**N.**

Ky është shëndet i parë,  
për dhëndërin, mor i marrë.

**A.**

Sa malet, o nun, të rrosh!  
Tani ku do t'më dërgosh';  
Se dua të pi një verë.

**N. (Numëron)**

Një, dy, tri... s'ka më të tjerë.

**A.**

Numuroi dhëntë mirë.

**N.**

Le të kollet kush s'ka pirë...  
Me mua, zoti Abaz.

**N.**

Të gjeça kurdo me gas.  
Këtë kupë do ta pi  
për shëndet të dhëndrit të ri.

**Gjithë tok.**

Shëndet të mirë të ketë  
dhe të gëzojë përjetë!

I zot' i shtëpisë rroftë  
dhe djali ju trashëgoftë!

### III

*(Soset dollia dhe prifti ngrihet e zë vallen me burra,  
duke kënduar).*

Do të them një këngë vetë,  
këngë prifti të vërtetë.  
Rroftë vështi dhe dhëria,  
rroftë vera dhe rakia,  
q'i ka bërë përëndia.  
Se dhe zoti Krisht një herë  
mori uj' e bëri verë.  
Moj verë, burim i gjakut,  
gaz' i djalit e i plakut!  
O raki, moj bukuroshe,  
që na hedh qoshe më qoshe!  
Se ç'bën vera e rakia,  
pin' e dejen trimëria,  
sa vjen rotullë shtëpia!  
Det i madh e det i gjerë,  
pse s'të bëri zoti verë,  
se do ta pinim pa blerë?

**IV**

*(Është natë: krushqit zën' e ikin duke uruar mëmën e dhëndërit, zonjën Tanë, që është shumë e gëzuar.)*

**N.**

Të të trashëgonen!

**B.**

Si bletë të shtonen!

**A.**

Me jetë t'u rrojnë!

**P.**

Dhe t'u pleqërojnë!

**T.**

U paça, të rroni,  
gjithë të gëzoni!

*(Një nga një ikin të tërë dhe mbeten vetëm ndë odë Tana me djalë e me nuse.)*

**T. (Tek i biri)**

Rri me nusen, djalë,  
dhe foli dy fjalë,  
të mos ketë frikë.

**Dhëndëri** (*I thotë s'ëmës.*)  
Ngreu mëm' e ikë.

*(Tana ikën.)*

**V.**

*(Dhëndëri me nusen mbeten vetëm)*

**DH.**

Lozëm ndonjë lodër?  
Të dua si motër.

**N.**

Ç'motër më ke mua,  
o lum' e përrua?  
Ti më more grua.

**Dh.**

Pse u zemërove  
dhe u hidhërove?  
Kur s'lot ndonjë lodër,  
s'të dua si motër,  
të dua si mëmë!  
Po hajde të flemë,  
se më mori gjumi.

**N.**

Fli të marrtë lumi!